



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

*Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738
E-mail: rmuca@klsb.org.al; Web-site: www.klsb.org.al*

Auditim Performance: PERFORMANCA E KESH SHA, "DOMOSDOSHMERIA E LIBERALIZIMIT TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE"

Përmbledhje Ekzekutive

Në zbatim të planit vjetor 2014, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI etj.), sipas shkresës nr. 363/1, datë 28.03.2014, njoftim për fillim auditimi, ndërmori auditimin me temë: Performanca e KESH Sha "Domosdoshmëria e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike".

Ky auditim u programua për t'u ushtruar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI), Entin Rregullator të Energjisë (ERE) dhe Korporatën Elektroenergetike Shqiptare (KESH) ShA, pasi këto janë institucionet që përcaktojnë sjelljen e operatorëve dhe Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri. MEI është përfshirë në këtë auditim në cilësinë e institucionit përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave në krijimin e një sistemi të energjisë elektrike të qëndrueshëm operacionalisht, teknikisht dhe financiarisht, të aftë për të plotësuar kërkesën në rritje për energji elektrike; rritjen e efikasitetit të përdorimit saj në sektorë të ndryshëm të ekonomisë; kryerjen e një reforme legislative - strukturore në sistemin elektro-energjetik dhe në tregun e energjisë elektrike, duke plotësuar kushtet për liberalizimin e shitjes së energjisë elektrike në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian etj. ERE, ka përgjegjësi, midis të tjerave për përcaktimin dhe rregullimin e tarifave të shitjes me shumicë dhe me pakicë, afatet dhe kushtet e shërbimit të energjisë elektrike; mbrojtjen e interesave të konsumatorëve të energjisë elektrike për tarifën, ruajtjen ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit, investitorëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në sektorin e energjisë elektrike, nxitjen e konkurrencës në sektorin e energjisë elektrike etj. Ndërsa KESH ShA luan një rol të rëndësishëm në sektorin energjetik, duke optimizuar teknikisht dhe ekonomikisht prodhimin vendas dhe shitjen/shkëmbimin e energjisë elektrike, për të siguruar furnizimin e qëndrueshëm dhe me kosto të ulët për klientët tariforë, paralelisht me vënien në punë të burimeve të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese.

Pas përfundimit të punës paraprake audituese më datë 08.07.2014 u përgatit programi auditues. Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr 363/3, datë 27.09.2014 iu dërgua projekt-raporti i auditimit subjekteve të audituara. Raporti përfundimtar është hartuar pasi është shqyrtuar observacioni dhe shpjegimet e dërguara nga KESH ShA me shkresën nr. 363/4 prot., datë 22.10.2014, opinionet e ERE dërguar me shkresën nr. 363/5 prot., datë 04.11.2014 duke ndarë të njëjtin qëndrim me auditimin e KLSH për nevojën e implementimit të një ligji të ri të sektorit të energjisë elektrike në

përputhje me angazhimet e vendit në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe pas konsultimeve me palët e interesit.

Në përfundim, pasi Kryetari u njoh me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997, “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000:

K O N K L U D O I:

Për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Entin Rregullator të Energjisë dhe Korporatën Elektronergjetike Shqiptare (KESH) Sha:

Sistemi elektro-energjetik shqiptar, si rezultat i akumulimit të problemeve në vijimësi pas viteve '90, gjendet përballë sfidash shumë-dimensionale: me natyrë strategjike, teknologjike e operacionale, tregtare e financiare, duke vënë në rrezik jo vetëm zhvillimin e funksionimit normal të vetë këtij sistemi, por dhe integrimin e tij në sistemet rajonale të energjisë dhe investimet e reja për prodhimin e energjisë elektrike, si dhe duke u bërë pengesë serioze për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të vendit tonë. Në këtë kuadër përfshihen edhe pasojat mbi KESH Sha, si subjekti kryesor i këtij sistemi për furnizimin e qëndrueshëm me energji elektrike në standarde tekniko-ekonomike për konsumatorët.

Gjendja financiare e KESH Sha, në fund të viti 2013, rezulton me mungesë të likuiditeteve si rezultat i blerjes së energjisë elektrike të furnizuar por të papaguar (përfshirë dhe energjinë për mbulimin e humbjeve) të CEZ Shpërndarje (aktualisht OSHEE), të cilat janë në shumën 53.7 miliard lekë; nga OSSH (aktualisht OSHEE), sipas Urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr. 500, datë 01.07.2008, janë transferuar të gjithë klientët e pa arkëtuar përpara vitit 2006 me vlerë prej 40.7 miliard lekë; blerjet nga HEC-et private dhe ato koncesionare nga viti 2010 e në vazhdim kanë bërë që KESH Sha marrë overdrafte në shumën 214.926.755 euro ose 30.1 miliard lekë në fundin e vitit 2013, të cilët kanë pësuar rritje në masën 340 % etj. Për pasojë KESH Sha është ndëshkuar nga gjykata, organet përmbarimore dhe administrata tatimore me penalitete e dëmshpërblime në shumën 4.1 miliard lekë etj.

Në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2003-2015, krahas disa arritjeve si: përmirësimi i kuadrit ligjor të sektorit energjetik; ristrukturimi, ndarja dhe privatizimi i disa shoqërive tregtare të rëndësishme të këtij sektori; fuqizimi i infrastrukturës transmetuese në këtë sektor etj., konstatohet se disa probleme nuk kanë gjetur akoma zgjidhje si: mungesa e diversifikimit të burimeve primare energjetike; kapaciteti ekzistues gjenerues i pamjaftueshëm për të përballuar kërkesën në rritje për energji elektrike; humbjet në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike të cilat vazhdojnë të jenë të larta (për vitin 2012 ato ishin në nivelin zyrtar rreth 46 %); privatizimi i dështuar i sistemit të shpërndarjes së energjisë dhe mungesa e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike; boshllëqet në plotësimin e kuadrit ligjor mbi energjinë dhe eficiencën e saj etj.

Sigurimi i furnizimit të pandërprerë me energji elektrike është një çështje e sigurisë kombëtare, zhvillimit ekonomik të vendit, si edhe një çështje sociale në aspektin e ofrimit

të këtij shërbimi dhe çmimit përkatës të paguar nga konsumatori. Aq më tepër, në kuadrin e aspiratës së anëtarësimit të vendit tonë në BE dhe pjesëmarrja paraprake në organizmat e saj (në këtë rast për energjinë elektrike) e detyrojnë vendin tonë të përafrojë legjislacionin, organizimin dhe veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike (pra të këtij sektori) me atë të vendeve të tjera evropiane.

Në zinxhirin e hallkave të kuadrit rregullator për sigurimin e furnizimit me energji elektrike është përcaktuar kompania publike KESH ShA. Kjo do të thotë se nga mënyra se si organizohet, detyrat që i vihen, se si administrohet kjo korporatë, varet në një masë të konsiderueshme cilësia dhe kosto e energjisë elektrike të ofruar tek konsumatori, pra në mënyrë indirekte ndikojnë në nivelin e jetesës së konsumatorit nëpërmjet shpenzimeve për energji elektrike. Aktualisht KESH ShA, për shkak të mënyrës së organizimit dhe administrimit, nivelit të hapjes së tregjeve, mungesës së strategjive afatgjata për zhvillimin e sektorit energjistik të shoqëruara me planin e masave të zbatimit dhe kostot përkatëse, ndërhyrjet qeveritare në dëm të saj, raporte të detyrueshme me operatorë privatë (megjithëse funksionon si shoqëri publike), është në një pozitë të disfavorshme në këtë sektor për shkaqet e mësipërme, gjë që reflekton në fund të fundit cilësinë dhe koston e furnizimit me energji elektrike.

Ngarkimi me funksionin e prodhuesit publik të energjisë, garantimin e blerjes së energjisë së prodhuar nga HEC-et e privatizuara dhe të dhëna me koncesion, si dhe ndërtimi i marrëdhënieve të tilla kontraktuale me çmime të rregulluara (të diktuar ose nga ERE ose nga qeveria në marrëveshjet koncesionare), si dhe në disa raste sigurimi i importit (blerjes) së energjisë elektrike për llogari të mbulimit të humbjeve të CEZ Shpërndarje, jo vetëm që e kanë denaturuar funksionin themelor të një shoqërie publike (sigurimin e fitimit dhe rritjen e efektivitetit), por e kanë zhytur në detyrime financiare ndaj klientëve, duke e bërë domosdoshmëri ndryshimin e mënyrës se funksionimit, administrimit dhe menaxhimit, nëpërmjet ndarjes së përgjegjësive: prodhimi nga blerja (import dhe/ose blerje nga HEC-et e dhëna me koncesion), si dhe hapjen e tregut të energjisë elektrike, të cilat do të reflektohen në fund të fundit në cilësinë dhe koston e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve.

KLSH auditori KESH ShA, MEI, si dhe ERE duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve që lidhen me prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike në funksion të objektivave individuale të KESH ShA; modelin e tregut të energjisë elektrike që të sigurojë qëndrueshmërinë dhe përmirësimin e infrastrukturës së sistemit hidro-energjitik dhe ndikimin e tij në situatën ekonomike dhe financiare të KESH Sha; marrëdhëniet e kësaj të fundit me prodhuesit e vegjël e privatë të energjisë elektrike dhe performancën e marrëdhënieve tregtare midis KESH ShA dhe CEZ Shpërndarje (aktualisht Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike); performancën e Strategjisë Kombëtare të Energjisë në fushën e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike, si edhe përfshirjen e direktivave të BE-së në kuadrin ligjor ekzistues për energjinë elektrike.

Bazuar në sa më sipër, KLSH është përpjekur t'i japë përgjigje pyetjes: **“A duhet të fokusohet KESH ShA vetëm në prodhimin dhe shitjen e energjisë elektrike në funksion të objektivave individuale si shoqëri aksionere?”**, duke konsideruar veçanërisht cilësinë dhe koston e furnizimit me energji elektrike tek konsumatori final, u arrit në përfundimin se:

“Ngarkimi me funksionin e prodhuesit publik të energjisë, garantimi i blerjes së energjisë së prodhuar nga HEC-et e dhëna me koncesion, si dhe ndërtimi i marrëdhënieve kontraktuale me çmime të rregulluara (të diktuar ose nga ERE,

ose nga qeveria në marrëveshjet koncesionare), sigurimi i importit (blerjes) së energjisë elektrike për llogari të CEZ Shpërndarje (aktualisht OSHEE), jo vetëm që e kanë denaturuar funksionin themelor të një shoqërie publike (sigurimin e fitimit dhe rritjen e efektivitetit), por e kanë zhytur atë në detyrime financiare ndaj klientëve, duke e bërë domosdoshmëri ndryshimin e mënyrës së funksionimit, administrimit dhe menaxhimit, nëpërmjet ndarjes së përgjegjësisë (prodhimi nga blerja: importi dhe/ose blerja e energjisë nga HEC-et e dhëna me koncesion), si dhe hapjen e tregut të energjisë elektrike, të cilat do të reflektohen në fund të fundit në cilësinë dhe koston e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve”

Nisur nga konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij sektori Kryetari i KLSH-së:

V E N D O S I:

I. Të miratojë Raportin Përfundimtar të Auditimit Performancës së KESH ShA, “Domosdoshmëria e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike”, të ushtruar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, Entin Rregullator të Energjisë dhe Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare ShA.

II. Të miratojë rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkojë marrjen e masave për sa vijon:
a) Mbi ndikimin e Modelit aktual të tregut të energjisë elektrike në situatën ekonomike dhe financiare të KESH ShA. Meqenëse:

- Modeli aktual i tregut nuk ka arritur synimet e veta për të krijuar strukturën e nevojshme që të ketë konkurrencë në tregun e shitjes me shumicë, si dhe ka dështuar në krijimin strukturave të nevojshme ligjore dhe rregullatore për privatizimin e suksesshëm të industrisë elektro-energjetike, duke filluar me sektorin e Shpërndarjes;
- Modeli i tregut ka dështuar në drejtim të: sigurimit përfitimeve sa më të mëdha për klientët në drejtim të sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe shërbim cilësor e të qëndrueshëm; liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, për të krijuar një strukturë tregu që rrit interesin dhe numrin e pjesëmarrësve në të; zhvillimin e një reforme tarifore me interes për mbrojtjen e konsumatorëve dhe njëkohësisht për rritjen e eficiencës së sistemit elektro-energjetik shqiptar; integrimin e tregut të energjisë elektrike të vendit tonë në Tregun Rajonal e më vonë në Tregun Evropian të Energjisë Elektrike;
- Ka një situatë të komplikuar të tregut të energjisë elektrike në vendin tonë, i cili nuk mundëson ndërhyrjen me strategji dhe politika afatgjata në këtë sektor, duke ndikuar për rrjedhojë në performancën e pjesëmarrjes në tregun rajonal dhe më gjerë;
- Si rezultat i shtimit të vazhdueshëm të futjes në rrjetin e shpërndarjes të HEC-eve të dhëna me koncesion, krahas përmirësimit potencial të qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve si rezultat i shtimit të prodhimit, kemi aktualisht përkeqësim të situatës financiare të KESH Sha. Ky përkeqësim vjen si rezultat i raportit të detyruar vendosur nga ERE për tarifën blerjes prej tyre, disa herë më të lartë kjo sesa çmimi i shitjes tek Operatori i Shpërndarjes, madje në disa raste me tarifa blerjeje edhe më të larta sesa çmimet e importit;
- Një pjesë e stafit menaxhues dhe administrues të KESH ShA nuk ka një vizion të qartë mbi gjendjen aktuale ekonomike dhe financiare të shoqërisë, shkaqet, pasojat

dhe mendime mbi perspektivën e zhvillimit të shoqërisë, kjo për shkak dhe të ndryshimeve në nivelin e mesëm dhe të lartë menaxhues, i përcaktuar nga grupi i auditimit edhe si një nga risqet e suksesit të subjektit.

- Prodhimi publik i KESH ShA (p.sh në vitin 2013 prej 5.811.762 Mwh) është më se i mjaftueshëm për të garantuar furnizimin aktual me energji elektrike të popullatës (i cili për vitin 2013 ka pasur nevoja vjetore 2.261.313 Mwh), edhe me përfshirjen nivelit aktual të humbjeve, i cili detyrimisht me ndryshimin e pronësisë së operatorit të shpërndarjes dhe përmirësimet në menaxhim dhe administrim do të vijë duke u zvogëluar. Prodhimi i kësaj sasive energjie nga KESH ShA me kosto shumë të ulët (1,14 lekë/kwh në vitin 2013), shitja me tarifë të caktuar nga ERE (2,3 lekë për vitin 2013) Operatorit të Shpërndarjes (CEZ-it, sot OSHEE) dhe blerja nga konsumatori me një çmim prej 7,7 dhe ose 13,5 lekë për kwh dëshmon për marzhe pozitive dhe të konsiderueshme fitimi të operatorëve të përfshirë, madje theksojmë se çmimi final që paguhet nga konsumatori është nga më të lartët në rajon, në një kohë që për nga niveli i mirëqenies (të ardhurave) vendi ynë renditet në fund;
- 1. ERE, të hartojë një strategji me afate të mirë përcaktuara për ndryshimin e modelit të tregut të energjisë elektrike në funksion të kalimit gradual në një treg të liberalizuar, me synim rritjen e konkurrencës; zhvillimin e një reforme tarifore me interes për mbrojtjen e konsumatorëve; integrimin e këtij tregu në Tregun Rajonal dhe atë Evropian të Energjisë Elektrike, duke siguruar qëndrueshmëri dhe shërbim cilësor në furnizimin me energji elektrike.

Deri në fund të muajit qershor 2015

- 2. MEI dhe ERE të realizojnë ndarjen e Divizionit të Furnizimit Publik me Shumicë nga KESH ShA, si strukturë më vete, duke e vendosur KESH ShA si operator në treg në cilësinë e prodhuesit dhe tregtuesit të energjisë elektrike, duke bërë të mundur fuqizimin ekonomik dhe financiar të KESH ShA në funksion të rritjes së efektivitetit të përdorimit të burimeve hidrike në kaskadën e Drinit (e vetmja publike aktualisht); përmirësimin e teknologjisë ekzistuese dhe për pasojë uljen e koston, si dhe mundësimin e burimeve të tjera për rritjen e prodhimit dhe diversifikimin e burimeve elektrike.

Deri në fund të muajit qershor 2015

- 3. MEI dhe ERE, bazuar në kushtet aktuale të modelit ekzistues të tregut dhe pozicionimit të operatorëve në këtë sistem, si edhe në perspektivën e ndryshimeve të mundshme, të sigurojnë ruajtjen e çmimeve aktuale të energjisë elektrike për konsumatorët familjarë, pasi: arsyet e mungesës së eficiencës në këtë sektor nuk kanë lidhje me çmimin, por mosarkëtimin dhe rregullat e tregut në përgjithësi; rritja e çmimit të energjisë penalizon konsumatorët korrektë dhe favorizon vjedhësit e energjisë, duke sjellë komplikime sociale; rritja e çmimit të energjisë elektrike rrit gjithashtu presionin inflacionist për ekonominë në tërësi, gërryen fuqinë blerëse dhe madje mund të shpjerë në rënie të ritmit të rritjes. Përfundimisht, rritja e çmimit të energjisë duhet të konsiderohet nga MEI si alternativë e fundit e përmirësimeve në këtë sektor dhe shoqërinë në përgjithësi; kjo pasi humbjet të jenë reduktuar në nivele të pranueshme, pasi tregu të jetë liberalizuar dhe konkurrenca të veprojë normalisht, si

dhe pasi të jetë bërë një studim i plotë dhe i kujdesshëm i efekteve e risqeve në ekonomi dhe harmonizimit me politikat monetare, fiskale e sociale.

Deri në fund të vitit 2015

4. ERE duhet të harmonizojë më mirë domosdoshmërinë e rritjes së burimeve elektro-energjetike nga Hece-t e dhëna me koncesion me interesin e biznesit pjesëmarrës në këtë aktivitet, nëpërmjet politikave të çmimeve, ku mbi bazën e madhësisë së investimit dhe sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike, të llogaritet për secilin prej tyre periudha e vetëshlyerjes së investimit dhe gradualisht prodhimi i këtyre subjekteve të kalojë në çmime tregu, pavarësisht ndryshimeve organizative dhe administrative që mund dhe duhet të ndërmerren në KESH ShA.

Deri në fund të muajit qershor 2015

b) Mbi përputhjen e marrëdhënieve tregtare midis KESH ShA dhe prodhuesve të vegjël e privatë të energjisë elektrike. Meqenëse:

- “Çlirimi” i KESH ShA nga sigurimi i furnizimit me 14 % të sasisë së nevojave për energji elektrike, i shoqëruar me zvogëlimin e kapaciteteve prodhuese si rezultat i privatizimeve të fundit, nuk ka ndikuar në pozicionin e saj në treg, përveçse në një farë mënyre solli pasoja negative në gjendjen e saj financiare, për shkak të nevojës së sigurimit me çmime shumë herë më të larta se kostoja e prodhimit të tyre;
 - Për shkak të modelit të tregut të rregulluar, KESH ShA blen energjinë elektrike të prodhuar nga HEC-et private dhe koncesionare me një tarifë shumë më të lartë se kosto e prodhimit të vet dhe ia shet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes me një çmim të rregulluar nga ERE, disa herë më të ulët nga kostoja e blerjes, duke i shkaktuar kompanisë kosto financiare shtesë, të cilat për shkak të paqëndrueshmërisë së prodhimit, rriten vazhdimisht duke u bërë të papërballueshme për këtë shoqëri;
 - Metoda e vendosjes së tarifës së blerjes nga KESH ShA të prodhimit të koncesionarëve dhe prodhuesve të vegjël mbi bazën e çmimit të importit të një viti më parë, mbart riskun që tarifatat e blerjes të jenë më të larta se çmimi aktual i importit të energjisë elektrike, duke i shkaktuar KESH-it kosto financiare shtesë dhe përkeqësim të perspektivës së zhvillimit dhe ulje të eficiencës së prodhimit publik të energjisë elektrike;
 - Pamundësia reale e parashikimit të sasisë së prodhimit të energjisë elektrike nga privatët dhe koncesionarët, për shkak të varësisë hidrologjike, si dhe detyrimi për blerjen me përparësi të prodhimit (edhe këta operatorë e prodhojnë energjinë elektrike nëpërmjet derivacionit, pra periudha e prurjeve të konsiderueshme në kaskadën e lumit Drin korrespondon për të gjithë në të njëjtën kohë), KESH ShA ka pasur raste që ka derdhur ujë nga HEC-et në administrim të saj, duke zvogëluar si efektivitetin, ashtu edhe rezervën hidrike me pasoja negative financiare për shoqërinë;
 - Marrëdhëniet tregtare të KESH ShA me prodhuesit e vegjël dhe privatë të energjisë elektrike jo vetëm që nuk kanë siguruar një normë fitimi në rritje nga viti në vit nëpërmjet tarifave, por në fakt ka ndodhur e kundërta, duke rezultuar me borxhe të shumta krahas kredive të marra për investimet në këtë sektor.
1. MEI dhe ERE, të ndërmarrin hapat e nevojshëm për ndryshime në kuadrin ligjor e më pas edhe në atë rregullator, me qëllim që KESH ShA t’i hiqet detyrimi për blerjen e energjisë nga prodhuesit e vegjël dhe privatë të energjisë elektrike, në përmbushje të plotë të funksioneve të KESH ShA, për të vijuar rolin e rëndësishëm në sektorin

energjetik, duke optimizuar teknikisht dhe ekonomikisht prodhimin vendas dhe shitjen/shkëmbimin e energjisë elektrike, për të siguruar furnizimin e qëndrueshëm dhe me kosto të ulët për klientët tariforë, paralelisht me vënien në punë të burimeve të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistuese.

Deri në fund të muajit qershor 2015

c) Mbi performancën e marrëdhënieve KESH ShA me kompaninë CEZ Shpërndarje (aktualisht OSHEE). Meqenëse:

- Nuk ka pasur përpjekje serioze nga ana e OSSH (më vonë CEZ Shpërndarje) për mbledhjen e detyrimeve debitorë të konsumatorëve para vitit 2006 në shumën 40.938.168 mijë lekë, pasi në periudhën 2008-2013 është arritur të arkëtohen për llogari të KESH ShA vetëm 509.405 mijë lekë, pa pasur të dhëna të sakta për shumën e arkëtuar në fakt nga CEZ-i; mungojnë gjithashtu të dhëna të detajuara për debitorët;
- KESH ShA ka shfaqur performancë të dobët për vjeljen e detyrimeve të mësipërme, pasi “Sektori i detyrimeve të prapambetura” me 19 punonjës, në periudhën 2010-2013 ka arritur të arkëtojë vetëm 3.542 mijë lekë; nga mosveprimi për një kohë të gjatë dhe mungesa e bashkëpunimit në vitin 2016 parashkruhen plotësisht këto detyrime, duke rrezikuar që të mos arkëtohet asnjëherë ky detyrim financiar.
- Nga moszbatimi i detyrimeve kontraktore të CEZ Shpërndarje për pagesën e sasisë së energjisë së blerë nga KESH ShA, për garantimin e furnizimit me energji elektrike megjithëse e blerë me çmimin me shumicë 2,2 lekë/kwh dhe e shitur me pakicë nga CEZ me 7,5 lekë/kwh dhe 13,7 lekë kwh, i ka krijuar KESH-it një deficit prej së paku 28.739.223.700 lekë.
- Nga detyrimi i KESH ShA, me Vendim të Këshillit të Ministrave për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të CEZ Shpërndarje dhe mospagesave të CEZ-it të kostos së blerjes për këtë sasi energjie, i ka krijuar KESH-it detyrime debitorë në shumën e së paku 19.270.823.600 lekë, që duke shtuar dhe penalitetet për pagesë të vonuar, detyrimet e CEZ Shpërndarje ndaj KESH ShA për te dy rastet e mësipërme arrijnë në 53.735.648.300 lekë.
- Nga konsiderimi që i ka bërë Ministria e Financave gjetjes së burimeve të financimit për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të CEZ Shpërndarje, për KESH ShA duke lëshuar garanci huaje ka bërë që në fund të vitit 2013, KESH ShA të ketë detyrime për hua dhe overdrafte në shumën 30.132.731.000 lekë.

1. KESH ShA dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (ish-CEZ Shpërndarje), nën mbikëqyrjen dhe udhëheqjen metodologjike të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, të krijojnë një grup të përbashkët dhe të hartojnë, nënshkruajnë dhe të vënë në zbatim një marrëveshje mbi saktësimin dhe mundësinë e përdorimit të të gjitha rrugëve ligjore për vjeljen e detyrimeve debitorë të para vitit 2006, duke ja kaluar këtë detyrë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, tashmë pronë publike.

Deri në fund të vitit 2014

2. KESH ShA, bazuar në performancën e dobët të “Sektorit për detyrimet e prapambetura” (pagat e tyre janë mesatarisht 8-fishi i arkëtimeve nga këto detyrime), të riorganizojë këtë sektor, duke reduktuar ndjeshëm numrin e punonjësve, mbi bazën e marrëveshjes përkatëse me OSHEE për vjeljen e detyrimeve të mundshme.

Deri në fund të vitit 2014

3. MEI të marrë masat e nevojshme për ta përfshirë KESH ShA në subjektet për subvencionim për likuidimin e huave dhe overdrafteve të shpenzuara për blerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve të CEZ Shpërndarje.

Menjëherë

d) Mbi performancën e Strategjisë Kombëtare të Energjisë 2003-2015, në fushën e prodhimit dhe furnizimit me energji elektrike. Meqenëse është konstatuar:

- Mungesa e realizimit të planit të përbashkët të veprimeve me institucionet përkatëse, përgjegjëse për zbatimin e kësaj strategjie deri në vitin 2015, në kundërshtim me VKM Nr. 647, datë 11.9.2003.
- Nuk është realizuar çdo dy vjet përditësimi i kësaj Strategjie për t'ia paraqitur për miratim Këshillit të Ministrave, në kundërshtim me pikën 3 të VKM Nr. 647, datë 11.9.2003;
- Nuk është monitoruar zbatimi i kësaj strategjie dhe raportimi pranë Komitetit Ndërmintor të Energjisë, për rezultatet dhe problemet e konstatuara, duke shkaktuar pasoja në fushat dhe subjektet e përfshira në këtë Strategji;
- Nuk janë siguruar kapacitete të reja gjeneruese të prodhimit të energjisë elektrike në periudhë afatgjatë pas vitit 2005, siç ishin parashikuar shtimi i kapaciteteve të tjera termike, HEC-i i Bratilës në 2009, HEC-i i Kalivaçit në vitin 2013, si dhe TEC-et, të cilat nuk janë zhvilluar, duke sjellë si pasojë rritjen e konsumit të energjisë, mungesën e diversifikimit, si dhe cenimin e sigurimit të furnizimit në mënyrë të vazhdueshme me energji elektrike.
- Nuk janë marrë masat sipas strategjisë për investime për zëvendësimin e energjisë elektrike për ngrohje, gatim me LPG dhe lëndë të tjera djegëse, duke sjellë si pasojë rritjen e konsumit të energjisë elektrike, uljen e eficiencës së saj, si dhe pasigurinë e furnizimit të vazhdueshëm me energji elektrike.
- Privatizimi i HEC-eve në pronësi publike: Hec Lanabregas në 2011, Bistrica 1 dhe 2, si dhe Ulzë e Shkopet në vitin 2012, pa qenë parashikuar në këtë Strategji, kanë përkeqësuar peshën e prodhimit publik të energjisë elektrike në totalin e gjenerimit, si dhe situatën financiare të kompanisë publike KESH ShA.

1. MEI, të hartojë dhe të miratojë Strategjinë Kombëtare të Energjisë së bashku me planin e veprimit, në të cilën të përcaktohen afatet kohore dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e saj, si dhe monitorimi i vazhdueshëm, në funksion të politikave afatgjata të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, në përputhje me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian.

Deri në fund të vitit 2015

2. MEI të arrijë që Strategjia Kombëtare e Energjisë, nëpërmjet politikave të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike, të sigurojë rritjen e kapaciteteve të prodhimit të energjisë elektrike, diversifikimin e burimeve, liberalizimin e mëtejshëm të tregut, si dhe rritjen e efektivitetit të përdorimit në funksion të furnizimit me energji të lirë dhe të garantuar për konsumatorin.

Vazhdimisht

3. MEI, duke u bazuar në marrjen e masave për zvogëlimin e humbjeve të energjisë elektrike drejt nivelit të humbjeve teknike, si dhe koston e ulët të prodhimit të energjisë elektrike dhe çmimin e lartë të shitjes konsumatorëve familjar, në Strategjinë Kombëtare të Energjisë duhet të mundësojë përfshirjen e politikave për uljen e çmimit të shitjes së energjisë konsumatorëve familjarë, masë e cila do të shoqërohet me përmirësim të arkëtimit për shkak të rënies së motivit për të rrezikuar vjedhjen e energjisë, uljen e kostove të biznesit dhe përgjithësisht në rënien e çmimeve.

Deri në fund të vitit 2015

e) Mbi kuadrin ligjor ekzistues për energjinë e elektrike dhe pasojat në problematikën aktuale të sektorit hidro-energjetik. Meqenëse:

- Ka pasur ndryshime të shpeshta dhe të shumta të ligjit që rregullon gjithë veprimtarinë e sektorit elektro-energjetik (që nga viti 2008 deri më sot është ndryshuar 11 herë në disa nene të cilat kanë adoptuar zhvillimet e tregut), duke reflektuar pjesërisht dhe në mënyrë spontane sfidat e ndryshme të sektorit elektro-energjetik, të cilat deri tani nuk sigurojnë një përfaqësim të plotë me direktivat dhe praktikatat më të mira evropiane;
- Ekzistenca e tregut të rregulluar të energjisë elektrike dhe jo të liberalizuar (në pjesën më të madhe dhe/ose plotësisht), i cili me tarifatat e aplikuara në këtë sistem “ngarkon” financiarisht prodhuesin publik (KESH ShA) me kosto shtesë për përballimin e tarifave preferenciale kundrejt prodhuesve të vegjël të energjisë elektrike, si edhe për importin e saj në rast nevojë; përfshirë mungesën e zgjerimit të kapaciteteve publike prodhuese të energjisë elektrike, në kushtet e rritjes kërkesës për energji elektrike, si edhe të mungesës së diversifikimit të burimeve gjeneruese, duke vazhduar të qenit ndjeshëm nën varësinë e kushteve klimaterike (reshjeve);
- Situata e përkeqësuar financiare të të gjithë operatorëve tashmë publikë të sistemit elektro-energjetik: KESH, OST dhe OSHEE - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë elektrike (ish-OSH, më vonë CEZ Shpërndarje), të cilat së bashku ndikojnë në cilësinë, garantimin e furnizimit me energji elektrike, si edhe çmimin e shitjes së energjisë elektrike tek konsumatorët familjarë.

1. ERE nëpërmjet liberalizimit gradual të tregut të energjisë elektrike në vendin tonë, të bëjë që KESH ShA në cilësinë e prodhuesit të vetëm publik, të sigurojë furnizimin me energji elektrike vetëm të konsumatorëve familjarë, duke e përcaktuar këtë shoqëri si të gjithë operatorët e tjerë në tregun e energjisë elektrike.

Deri në fund të muajit qershor 2015

2. ERE, të përcaktojë në një seksion të veçantë të ligjit, raportet ekonomike dhe financiare të HEC-eve të vegjël dhe të drejtat e detyrimit përkatëse, duke u bazuar në një harmonizim më të mirë të interesave të ndërsjella publike dhe private, si dhe transferimit të drejtave dhe detyrimeve nga KESH ShA (Furnizuesi Publik me Shumicë-FPSH) tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes Energjisë Elektrike.

Deri në fund të muajit qershor 2015

3. ERE, të ndërmarrë studime lidhur me prodhimin mesatar të energjisë elektrike nga HEC-et private, duke llogaritur kthyeshmërinë e investimit në parametra kohor normal, mbi bazën e prodhimit dhe çmimit mesatar të blerjes, me qëllim që të mund

të arrihet një harmonizim sa më i mirë i interesave dhe partneritetit publik dhe privat në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike.

Deri në fund të muajit qershor 2015

Grupi i auditimit

Gjovalin Preçi
Andi Buzo
Odeon Smajli

Drejtori

Rinald Muça

Tiranë, Dhjetor 2014